



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITI OF LIPJAN

### DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Data:	04.09.2023
Për:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	z.Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z.Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Sead Aliu – Drejtor për Infrastrukturë
Lënda:	<b>Raport për muajin Gusht</b>

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës prej datës 01.08.2023 deri 31.08.2023, DI ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara. Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj jave ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
10	7	0	2	1

#### Aktivitetet gjatë muajit Gusht:

- Janë duke vazhduar punimet në rregullimin e infrastrukturës në fshatin Janjevë( afër përfundimit).
- Janë duke vazhduar punimet në rikonstruimin e rrugëve në Ribar të Madh ( rr.Vehbi Kozhani e Vehbi Duriqi),(afër përfundimit).
- Janë duke vazhduar punimet ndërtimi i ulseve për shikues dhe vendosja e barit artificial në fushat e hapura sportive në fshatrat Kraishtë, Ribar i Madh, Smallushë, Rufc, Gadime e Ulët dhe Sllovi(janë ndërprerë punimet për të vazhduar në muajt e ardhshëm).
- Kanë përfunduar punimet në qerdhen e Shalës.
- Kanë përfunduar punimet në qerdhen në Rufc te Ri(faza e parë).
- Janë duke vazhduar punimet në shtigjet e ecjes në Gadime (por gjatë gjithë kohës kemi probleme nga banorët të cilët pengojnë në proces të punimeve), punimet janë afër përfundimit.
- Kanë përfunduar punimet në ndërtimin e palestrës sportive në Gllgovc.
- Janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e shtratit të lumit fshatin Gadime,(por kemi disa pengesa pasi kemi pasur vërshime, punimet janë ndërprerë për të vazhduar në muajin e ardhshëm.
- Janë duke vazhduar punimet në shtigjet e ecjes në Sllovi, (mirëpo gjatë vërshimeve janë shfaqur disa probleme), janë afër përfundimit.

- **Kanë rifilluar punimet në ndërtimin e trotuarit në Krojmir (Kohë pas kohe probleme me banor, por të evitueshme), Momentalisht janë ndërprerë punimet për të vazhduar në muajin gusht.**
- **Janë duke vazhduar punimet në projektin Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Smallushë, Gomnasellë, Llugaxhi, (kanë përfunduar punimet në Gadime, janë duke vazhduar punimet në Babush, Llugaxhi dhe Sllovi).**
- **Janë duke vazhduar punimet në Ndërtimi i shtratit të lumit në Glllogovc.**
- **Kanë përfunduar punimet në Ndërtimi i këndeve të lojrave në Lipjan, Sllovi, Gadime.**
- **Janë duke vazhduar punimet në Ndërtimi i trotuarit Llugaxhi-Gadime**
- **Janë duke vazhduar punimet në Ndërtimi i shtratit të prrockave-lumenjve në qytetin e Lipjanit.**
- **Janë duke vazhduar punimet në projektin Zbatimi i masave efçiente në objektin qendra në Lipjan.**
- **Kanë filluar punimet në ndërtimin e hapur të fushës sportive në Rubovc.**
- **Kanë filluar punimet në rrugën “Afrim Zhitia” dhe “Bashkim Krasniqi”.**
- **Asfaltimi i rrugës tranzit lagjja e Konjuhut deri te rruga regjionale Lipjan-Janjevë.**
- **Kanë filluar punimet në shtratin e lumit në Smallushë.**
- **Kanë filluar punimet në sallën e sporteve në fshatin Banullë.**
- **Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën Ismail Luma në Lipjan.**
- **Kanë filluar punimet në shtratin e lumit dhe asfaltimi i rrugës në shtratin e lumit në Gadime.**

- **Kemi pas takim me projektues për disa projekte.**
- **Kemi pas takime me qytetar.**
- **Kemi shqyrtuar kërkesat e qytetarëve.**
- **Kemi vizituar punimet në disa projekte, të cilat janë duke vazhduar punimet.**